

# **Rregullimi i Tregut Bankar**

---

**Dr. Elvin MEKA**

**6**

## *Nevoja për rregullim të tregut bankar (I)*

**Dy çështje kryesore në kuadër të rregullimit bankar:**

- 1. Rreziku i panikut bankar nga problemet në një bankë të caktuar, që çon në probleme serioze likuiditeti në sistem;**
- 2. Nevoja për mbrojtjen e konsumatorit (klientit), nisur nga natyra e industrisë bankare.**

## *Nevoja për rregullim të tregut bankar (II)*

**Gjatë procesit të rregullimit bankar mbahet parasysh:**

- 1. Evitimi në maksimum i dëmit moral;**
- 2. Mbajtja në një nivel sa më të ulët e kostove të përputhshmërisë ligjore të sistemit bankar,**
- 3. Evitimi i ndërhyrjeve në konkurrencën e sistemit.**

## *Nevoja për rregullim të tregut bankar*

**Sigurimi i stabilitetit të sistemit bankar është synuar të arrihet nëpërmjet formave të ndryshme:**

- 1. Ndarja e aktivitetit bankar tregtar nga ai i investimeve,**
- 2. Përcaktimi i bankës qendrore si “huadhënësi i shpresës së fundit”, aplikimi i skemave të sigurimit të depozitave, krijimi i barrierave të hyrjes në treg, etj.**

---

## *Çështjet kryesore në rregullimin bankar*

- 1. Mjaftueshmëria e kapitalit,**
- 2. Likuiditeti,**
- 3. Cilësia e aktiveve,**
- 4. Shkalla e përqendrimit të rreziqeve.**

## ***Çështjet kryesore në rregullimin bankar***

- 1. Mjaftueshmëria e kapitalit (*absorbimi i humbjeve dhe financimi i operacioneve bankare*),**
- 2. Likuiditeti (*aftësia për ripagimin në kohë të detyrimeve*),**
- 3. Cilësia e aktiveve (*aftësia e huamarrësve për të shlyer huatë*),**
- 4. Shkalla e përqendrimit të rreziqeve (*ekspozimi ndaj klientëve të veçantë*).**

## *Çështjet kryesore në rregullimin bankar*

**Globalizimi e vendosi sistemin financiar ndërkombëtar nën presionin e rrezikut të përhapjes dhe shtrirjes së efektit të falimentimit lokal të bankave në një rrafsh global.**

**Falimentimet më të spikatura (1974):**

- **Franklin National Bank (SHBA)**
- **Herstatt Bank, (Gjermani).**

## *Komiteti i Bazelit – Krijimi (I)*

**Shqetësimet në rrafsh global konkluduan në nismën e krijimit të një komiteti të përhershëm të autoriteteve mbikëqyrëse bankare, nën kujdesin e Bankës për Rregullime Ndërkombëtare – BIS (Bank for International Settlements) .**

**Komiteti përbëhej prej 12 përfaqësuesve të këtyre autoriteteve nga Group of Ten plus Luksemburgu (SHBA, Mbretëri e Bashkuar, Japoni, Gjermani, Francë, Itali, Kanada, Hollandë, Belgjikë, Suedi, Zvicër).**



## *Komiteti i Bazelit – Krijimi (II)*

**Synimi i Komitetit të Bazelit ishte krijimi i një zinxhiri lidhës midis regjimeve të ndryshme rregullatore bankare në vende të ndryshme me qëllim realizimin e një mbikëqyrje bankare të bazuar në disa parime të përgjithshme ndërkombëtare bazë.**

**Në 1975 nënshkruhet Marrëveshja e Bazelit (Basel Concordat) me synim ndarjen e përgjegjësive midis autoriteteve mbikëqyrëse kombëtare bankare.**

## *Akordi i Bazelit – Krijimi*

**Paqartësitë e krijuara nga Marrëveshja e Bazelit, lidhur me ndarjen e përgjegjësive mbikëqyrëse, falimentimi i Banco Ambrosiano në 1982, kriza Meksikane dhe e borxheve të vendeve të Amerikës Latine diktuan arritjen e Akordit të Bazelit të vitit 1988 (ose Bazel I).**

**Synimi kryesor ishte krijimi i një bazamenti të përbashkët rregullator për kapitalin bankar në rrafsh ndërkombëtar.**

## *Akordi i Bazelit – Krijimi (II)*

**Parimi kryesor i Bazel I: Mbulimi dhe adresimi i rrezikut të besueshmërisë (*credit risk*).**

- **Përcaktimi i një kapitali minimal (rregullator) në masën 8% të aktiveve të ponderuara me rrezik:**

***Kapitali = 8% x ponderimi i rrezikut x ekspozimin.***

## ***Akordi i Bazelit – Krijimi (III)***

**Kapitali ndahej në pjesët e mëposhtme përbërëse:**

**Kapitali bazë (Tier I – *core capital*):**  
**Përbëhet nga kapitali aksioner, rezervat dhe fitimi i pashpërndarë i vitit aktual.**

**Kapitali shtesë (Tier II - *supplementary capital*):** Fonde të disponueshme po jo në pronësi të bankës – borxhi i varur afatmesëm e afatgjatë, instrumente hibridë, rezerva të rivlerësimit. Madhësia e këtij kapitali  $\leq 100\%$  e kapitalit bazë.

## *Akordi i Bazelit – Krijimi (III)*

**Kapitali ekstra (Tier III) (i përcaktuar në 1996 si një element shtesë që merte parasysh rrezikun e tregut):**

- **borxhi i varur me afat minimal 2 vjeçar maturimi dhe i rishlyeshëm me miratim të autoritetit mbikëqyrës,**
- **Fitimet e akumuluar nga shitblerja e letrave me vlerë.**

# Rregullimi i Tregut Bankar

# 6

## *Akordi i Bazelit – Krijimi (IV)*

### **Ponderimi me rrezik (risk weight):**

Risk weight	Asset type
0%	Cash held
0%	Claims on OECD central governments (foreign currency)
0%	Claims on central governments (national currency)
20%	Cash to be received
20%	Claims on OECD banks
20%	Claims on non-OECD banks (<1 year)
20%	Claims on multilateral development banks
20%	Claims on foreign OECD public-sector entities
50%	Residential mortgage loans
100%	Claims on the private sector (firm debt, equity, ...)
100%	Claims on non-OECD banks ( $\geq 1$ year)
100%	Real estate
100%	Plant and equipment

# Rregullimi i Tregut Bankar

# 6

## *Akordi i Bazelit – Krijimi (V)*

### **Ponderimi me rrezik (risk weight):**

**Risk-asset ratio – an illustrative calculation**

<i>Asset</i>	<i>£ million</i>	<i>Weight fraction</i>	<i>Weighted (£m)</i>
Cash	25	—	—
Treasury bills	5	0.1	0.5
Other eligible bills	70	0.1	7.00
Secured loans to discount market	100	0.1	10.00
UK government stocks	50	0.2	10.00
Other instruments – government	25	0.2	5.00
– company	25	1.0	25.00
Commercial loans	400	1.0	400.00
Personal loans	200	1.0	200.00
Mortgage loans	100	0.5	50.00
<i>Total assets</i>	<i>1000</i>		<i>707.50</i>
<b>Off-balance-sheet risks</b>			
Guarantees of commercial loans	20	1.0	20.00
Standby letters of credit	50	0.5	25.00
<i>Total risk-weighted assets</i>			<i>752.50</i>
<i>Capital ratio 8%</i>			<i>60.2</i>

*Source: Bank of England 'Banking Supervision' Fact Sheet, August 1990.*

## *Kufizimet e Bazel I*

- 1. Diferencat në rregullat kontabël dhe ato fiskale kushtëzonin diferenca në madhësinë e kapitalit midis vendeve të ndryshme;**
- 2. Bazel I u fokusua vetëm në rrezikun e besueshmërisë; llojet e tjera të rreziqeve nuk u konsideruan (rreziku i normave të interesit, likuiditetit, i këmbimit valutor dhe ai operacional).**



## *Kufizimet e Bazel I (II)*

- 3. Nuk ekzistonte asnjë mekanizëm shpërblyes për bankat që reduktonin rrezikun e portofolit të investimit, pasi kërkesat për kapital nuk merrnin parasysh diversifikimin e rrezikut;**
- 4. Bankat ishin të detyruara të zbatonin të njëjtin standard rregullator për kapitalin, pavarësisht se ato angazhoheshin në operacione të ndryshme financiare;**
- 5. Nuk merrte parasysh vlerën e tregut të aktiveve të bankës.**

---

## *Kufizimet e Bazel I (II)*

**GJITHSESI KUSHTET E  
BAZEL I ISHIN VETEM  
KUSHTE MINIMALE!!!**

## *Bazel II*

**Bazel II (2006) përfshin në vetvete një rishikim të rëndësishëm të rregullave mbi rrezikun e besueshmërisë, në drejtim të ndjeshmërisë ndaj një diapazoni më të gjerë rreziqesh, sikundër dhe ndaj mbështetjes në eksperiencën e kompetencën e vetë bankës, bazat e të dhënave historike, metodologjitë, modelet dhe parametrat e manaxhimit dhe parashikimit të rrezikut të saj.**

## *Bazel II (II)*

**Bazel II erdhi si një plotësim i Bazel I, në drejtim të adresimit më të mirë të rreziqeve në kuadër të kërkesave për kapital, në përgjigje të novacionit financiar të kësaj periudhe.**

**Gjithashtu, Bazel II synoi të shpërblente bankat për përpjekjet e tyre për diversifikimin dhe reduktimin e rreziqeve.**

## *Bazel II (III)*

**Për më tepër, Bazel II nxiste përdorimin e sistemeve të brendshme të vlerësimit të rrezikut nga ana e bankave, për një përlllogaritje më të mirë të nevojave për kapital, duke marrë në konsideratë faktin se, ishte e vështirë për autoritetet mbikëqyrëse e rregullatore identifikimi dhe monitorimi i të gjithë rreziqeve ndaj të cilëve ekspozoheshin bankat.**

## *Bazel II (IV)*


**Bazel II bazohet në tre shtylla:**

- 1. Kërkesa për kapital minimal;**
- 2. Rishikimi i procesit të mbikëqyrjes dhe procesi i vlerësimit të brendshëm të bankave;**
- 3. Disiplina e tregut, ekspozim më madh i informacionit bankar dhe nxitja e praktikave të sigurta e të shëndosha bankare.**

# Rregullimi i Tregut Bankar

6

## *Bazel II (V)*



# Rregullimi i Tregut Bankar

# 6

## *Bazel II (VI)*

---

Pillar 1	Pillar 2	Pillar 3
Minimum capital requirements	Supervisory review	Market discipline
<i>Credit risk</i> <ul style="list-style-type: none"><li>● Standardised approach;</li><li>● Internal rating-based approach (foundation), and</li><li>● Internal rating-based approach (advanced)</li></ul> <i>Operational risk</i> <ul style="list-style-type: none"><li>● Basic indicator approach;</li><li>● Standardised approach, and</li><li>● Advance measurement approach.</li></ul> <i>Market risk</i> <ul style="list-style-type: none"><li>● Value-at-Risk approach</li></ul>	<i>Economic capital</i> <ul style="list-style-type: none"><li>● Assessment of risk system by the supervisory authority</li></ul>	<i>Transparency</i> <ul style="list-style-type: none"><li>● Disclosure requirements as to amount and composition of capital relative to risk profile</li></ul>


---



# Rregullimi i Tregut Bankar

# 6

## *Bazel II (VII)*



## *Bazel II (VIII)*

### *Shtylla 1 (qasja sasiore):*

- **Rreziku i besueshmërisë nuk paraqet asnjë ndryshim nga Bazel I, lidhur me nivelin e kapitalit rregulator,**
- **Përveç sa më lart, përllogaritja e mjaftueshmërisë së kapitalit përfshin dhe shpenzimet për mbulimin e rreziqeve të tregut dhe atij operacional.**

# Rregullimi i Tregut Bankar

# 6

## *Bazel II (IX)*

$$\frac{\text{Capital}}{\sum \text{Credit RWA} + 12.5 \times (\sum \text{Market risk CC} + \text{Oper. risk CC})} \geq 8\%$$

***ose***

$$\frac{\text{Tier 1} + \text{Tier 2} + \text{Tier 3}}{\text{Risk-weighted Assets} + (\text{Market Risk Capital Charge} \times 12.5)} = 8\%$$

## *Bazel II (X)*

### *Shtylla 2 (qasja cilësore):*

**Shtylla 2 u krijon hapësirë autoriteteve rregullatore kombëtare të përshtasin dhe plotësojnë aspektet rregullatore, lidhur me nivelin e kapitalit rregullator ( psh: mund të vendosin kërkesa më të larta për kapital minimal sesa parashikon Shtylla 1, për të përfshirë dhe llojet e tjera të rreziqeve.**

**Shtylla 2 gjithashtu u kërkon bankave zhvillimin dhe përdorimin e proceseve të brendshme (IRB – Internal Rating – Based approach) për vlerësimin e nevojave të tyre për kapital.**

## *Bazel II (X)*

### *Shtylla 2:*

**Sipas Shtyllës 2, bankave u kërkohej realizimi i:**

- **Testeve të rregullta prapavepruese të të ardhurave të realizuara, kundrejt modelit dhe**
- **Testeve të stresit sipas disa skenareve.**

## *Bazel II (XI)*

### **Shtylla 3:**

**Shtylla 3 i detyron bankat kryejnë një ekspozim më të madh dhe raportim të informacionit të tyre financiar në tregjet financiare, me objektivin e forcimit të disiplinës së tregut, duke i bërë praktikat e menaxhimit të rrezikut më transparente he mjedisin bankar më të sigurtë e më të fuqishëm nga ana operationale.**

## *Kufizimet e Bazel II*

**Kriza globale e vitit 2008 nxorri në pah disa kufizime të Bazel II:**

- **Kërkesa për kapital bazë prej 4% rezultoi e pamjaftueshme për të mbuluar humbjet në shkallë të gjerë,**
- **Përgjegjësia për përcaktimin dhe vlerësimin e rrezikut të palëve të tjera iu besua agjencive të klasifikimit të rrezikut, veprim ky që u provua i paqëndrueshëm dhe me konflikte interesi,**

## *Kufizimet e Bazel II (2)*

- **Kërkesa për kapital bazë nga natyra vazhdon të mbetet “prociklike”; gjatë periudhës së zgjerimit ekonomik rreziku i palëve të treta dhe ai sovran ulet, duke ulur kërkesat për kapital dhe anasjelltas,**
- **Bazel II në mënyrë të pakushtëzuar nxit procesin e titullizimit duke u mundësuar bankave shitjen e huave, ripaketimin e tyre dhe nxjerrjen jashtë bilancit të tyre, duke ulur aktivet e ponderuara me rrezik, rritur përdorimin e levës financiare nga bankat dhe ulur kërkesat për kapital.**



## *Propozimet për Bazel III*

- **Përkufizimi i kapitalit do të kufizohet tek aksionet e zakonshme dhe fitimin e pashpërndarë; Kapitali bazë (Tier 1) do të rritet nga 4.0% në 7.0%.**
- **Raporti kapitali i vet/aktive të ponderuara me rrezik do të rritet nga 2.0% në 4.5%. Sipas Bazel III, ky raport do të konsiderohet si pikë referuese duke zëvendësuar raportin e kapitalit bazë (Tier 1 capital ratio).**


## *Propozimet për Bazel III*

- **Propozohet një “rezervë kapitali” (“capital conservation” buffer), në masën mbi 2.5% që do të plotësohet me aksione të zakonshme; në periudha stresi (kur raporti i kapitalit të bankave bie nën 7.0%), institucionet financiare do të autorizohen të plotësojnë këtë rezervë kapitali duke mos shpërndarë dividendë ose bonuse.**
- **Propozohet një rezervë kapitali kundërciklike deri në 2.5% të aktiveve të ponderuara me rrezik, e aplikueshme vetëm në periudha të rritjes së madhe të huadhënies.**

# Rregullimi i Tregut Bankar

# 6

## *Propozimet për Bazel III*



## ***Ndikimi dhe problematika e mundshme nga Bazel III***

- **Rregullat e reja mbi kërkesat për kapital synojnë forcimin e stabilitetit të sektorit financiar.**
- **Gjithsesi, zbatimi i Bazel III mund të detyrojë institucionet e vogla financiare të ofrojnë më pak mundësi kreditimi, duke kufizuar aksesin në hua të bizneseve të vogla dhe të mesme.**

## ***Ndikimi dhe problematika e mundshme nga Bazel III***

- **Institucionet financiare jo-banka do vazhdojnë të përbëjnë rrezik për stabilitetin e sistemit financiar, pasi rregullimet e Bazel III nuk i mbulojnë këto institucione. Këto institucione (shoqëritë e sigurimeve, fondet e pensioneve, bankat e investimeve, etj) janë kontribues të mëdhenj me fonde dhe këto rregulla u ofrojnë këtyre një avantazh konkurrues në raport me bankat, duke i nxitur ato të marrin përsipër më shumë rrezik.**

---

## ***Ndikimi dhe problematika e mundshme nga Bazel III***

- **Financimi i tregtisë ndërkombëtare dhe procesi i titullizimit do të bëhet më i shtrenjtë (pasi propozohet një 5 – fishim i faktorit të tyre konvertues në kredi (nga 20% në 100%).**